



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1097 prot

Himarë, më 30.01.2025

VENDIM

Nr. 03 datë 30.01.2025

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE
NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN SI DHE NGA FONDET E
BUXHETIT VENDOR.**

Duke u mbështetur në ligjin nr 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24, si dhe ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 i ndryshuar me ligjin nr 9602, datë 28.07.2006, ligjit nr. 10252, datë 11.03.2010, ligjit nr. 25/2013, ligji nr. 47/2014, ligjit nr. 44/2016, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" neni 21, VKM nr. 955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike,, i ndryshuar dhe udhëzim nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%", vendimi nr 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar, Vendimin nr. 617 datë 22.9.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597 datë 4.9.2019.

Sipas projektvendimit të paraqitur nga drejtoria e çështjeve sociale arsimit dhe rinisë për kriteret e familjeve përfituese nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondet e buxhetit vendor Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 30.01.2025.

VENDOSI:

I. Të përfitojnë ndihmë ekonomike:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar më parë në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak të pikëve të pamjaftueshme dhe janë të varfëra.
2. Jetimët të cilët nuk janë në institucione.
3. Familje me kryefamiljarë femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
4. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune në kushte varfërie ekstreme.
5. Familje me probleme të thella sociale që nuk mundin të realizojnë proceset gjyqësore për zgjidhje martesë dhe vendimet për UMM.
6. Familje ekstremisht të varfëra që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin.

7. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me paaftësi/sëmundje të rënda të cilat nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushte të vështira socio-ekonomike;
8. Viktimat e dhunës në mardhëniet familjare për 6 muaj pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë të urdhërit të mbrojtjes.
9. Familjet të cilat janë skualifikuar nga sistemi për shkak të mosazhurnimit në kohë të tij e provuar me dokumenta si dhe raport social për gjendjen e familjes si familje në nevojë.
10. Në çdo rast dokumentacioni do të shoqërohet me raport social të përgatitur nga punonjësi social ose sipas rastit njësisia e mbrojtjes së fëmijëve, kordinatori kundër dhunës në familje etj.

II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 955 datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” ,të gjitha familjet do të trajtohen me ndihmë ekonomike pasi të jetë kryer paraprakisht vlerësimi sociol-ekonomik në familje;

1. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 955 datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 “Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”.
2. Për kushte të veçanta shoqërore ekonomike kërkohen dokumenta shtesë, si vërtetim nga reparti ushtarak, vërtetim nga drejtoria e burgut, nga prokuroria, nga spitali, shkolla,nga zyra e përmbarimit kur ndonjë anëtar i familjes kryen shërbimin ushtarak, kryen dënimin, ndodhet në gjendje arresti, në spital , në shkollë, ose ka detyrime, urdhër mbrojtje, vërtetim nga gjykata për proces divorci, vërtetim page ku disa prej këtyre vërtetime merren nga portali ‘ *e Albania* ’.

III. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, familjet që në përbërjen e tyre kanë qoftë edhe një anëtarë të familjes, që plotësojnë kushtet sipas përcaktimeve të pikës 9 të VKM nr. 955 datë 7.12 2016.

- a) Kryen ndarje të qëllimshe të anëtarëve të familjes dhe jetojnë në të njëjtën strehë nuk trajtohet kurorë e re, me përjashtim të rastit vajzë nënë;
- b) Nuk tërheq ndihmën ekonomike, brënda një afati 10 ditë nga dita e depozitimit në llogarinë bankare/kryerjes së pagesave nga Posta Shqiptare, për përfituesit e ndihmës ekonomike me përjashtim të rasteve kur ka ndudhur për shkaqe të arësyeshme si shëndetësore dhe fatkeqësi;
- c) Refuzon verifikimin e situatës socialekonomike në familje, refuzimi shoqërohet me procesverbal;
- d) Fsheh informacion ose kryen deklaram të rremë mbi të dhënat e kërkuara në shkronjën ‘a’,të pikës 1,të kreut të II, të këtij vendimi;
- e) Nuk deklarohet ndryshimet e situatës socialekonomike në deklaratën e paraqitjes çdo tre muaj të familjes;

- f) Refuzojnë përfshirjen në kushtet e formimit profesional ose refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, për anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nxitjen e punësimit.
- g) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, nuk rezultojnë punëkërkues të papunë, apo të vetëpunësuar pranë zyrave të punës.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Elena Memushaj

KRYETAR I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj

